

V E N D I M
Nr.250, datë 27.5.1993

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR TË LUFTËS KUNDËR DROGËS

Me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijohet Komiteti kombëtar i luftës kundër drogës, në të cilin marrin pjesë:
 - Drejtori i Drejtorisë së Policisë Kriminale në Ministrinë e Rendit Publik, i cili është edhe kryetar i këtij Komiteti.
 - Drejtori i Drejtorisë së Policisë së Rendit e Kufitare në Ministrinë e Rendit Publik.
 - Drejtori i kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.
 - Drejtori i Drejtorisë së Policisë Financiare në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.
 - Drejtori i Përgjithshëm i Doganave pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
 - Drejtori i Drejtorisë Farmaceutike në Ministrinë e Shëndetësisë.
 - Nga një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Arsimit.
2. Komiteti kombëtar i luftës kundër drogës varet nga ministri i Rendit Publik dhe funksionon si organ informues, bashkërendues veprimesh e këshillimor.
3. Komiteti mbidhet periodikisht, sipas procedurës që përcakton ministri i Rendit Publik.
4. Komiteti kombëtar i luftës kundër drogës kryen këto detyra:
 - a) Përcakton strategjinë në planin kombëtar të luftës kundër drogës.
 - b) Bashkërendon veprimtarinë ndërmjet dikastereve dhe përcakton fushat e bashkëpunimit e praktikat konkrete të luftës kundër trafikut të paligjshëm të drogës.
 - c) Organizon punën për përgatitjen e projekteve normative përkatëse në përputhje me konventat ndërkombëtare.
 - ç) Bashkëpunon me organizmat ndërkombëtarë e kombëtarë të luftës kundër drogës si UNDCP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Kontrollin Ndërkombëtar të Drogave) etj.
 - d) Shkëmben informacionet për ecurinë e veprimtarisë në lidhje me luftën kundër drogës me organet përkatëse, pa përfshirë informacionet e rezervuara.
 - dh) Siguron asistencën teknike të bashkërenduar e harmonizuar nga jashtë, në të gjitha fushat, duke përcaktuar përparësitë.
 - e) Bashkëpunon me Radiotelevizionin, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve për sensibilizimin e opinionit të të gjitha shtresave të shoqërisë për rrezikun e përdorimit të drogës dhe për rëndësinë e luftës kundër saj, duke synuar edukimin dhe rritjen e përgjegjësisë shoqërore.
 - ë) Informon periodikisht Këshillin e Ministrave për veprimtarinë dhe problemet kryesore që trajton Komiteti.
5. Në zbatim të këtij vendimi Ministria e Rendit Publik të përgatitë statusin e Komitetit, që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi